

20050821087

L I G J I
PËR KONTROLLIN E EKSPORTIT TË MALLRAVE DHE TEKNOLOGJIVE ME
PËRDORIM TË DYFISHTË

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet në të cilat mund të kryhet eksporti i mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, kompetenca e organeve shtetërore në kontrollin ndaj eksportit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë dhe obligimet e personave fizikë dhe juridikë që kryejnë eksportin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

Neni 2

Shprehje të veçanta që përdoren në këtë ligj e kanë kuptimin si vijon:

1. “mallra dhe teknologji me përdorim të dyfishtë” janë mallrat, teknologjitë dhe softverët që mund të përdoren për qëllime civile dhe ushtarake, të përcaktuara me këtë ligj;
2. “eksport i mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë” është eksporti dhe rieksporti i mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, që janë përcaktuar si të atilla me aktin e miratuar në bazë të këtij ligji;
3. “eksportues” është personi juridik ose fizik me seli në Republikën e Maqedonisë, që është regjistruar për kryerjen e eksportit dhe i cili ka pronësi ose të drejtën e dispozicionit me mallrat dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë.
4. “listë e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë” është lista e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, eksporti dhe rieksporti i të cilave kryhet në kushte të përcaktuara me këtë ligj;

Neni 3

Eksporti i mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë i nënshtrohet kontrollit, me qëllim të mbrojtjes së sigurisë, interesave ekonomike dhe interesave të politikës së jashtme të Republikës së Maqedonisë në përforcimin e sigurisë dhe paqes ndërkombëtare, si dhe për plotësimin e obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë.

II KOMISIONI PËR EKSPORTIN E MALLRAVE DHE TEKNOLOGJIVE ME PËRDORIM
TË DYFISHTË

Neni 4

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë formon Komision për eksportin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë (në tekstin e mëtejme: Komisioni).

(2) Komisioni përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarëve si vijon, kryetar është përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe nga një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë, Sekretariati Legjislativ dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(3) Komisioni nga paragrafi (1) të këtij neni i kryen punët si vijon:

- ia propozon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë listat nga neni 5 të këtij ligji;
- paraqet iniciativa për rregullimin e çështjeve me rëndësi për kontrollin e eksportit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, me këtë ose ligj tjetër;
- realizon bashkëpunim me institucionet dhe trupat kompetentë ndërkombëtarë për çështje nga kompetenca e tij;

- jep mendime për lëndët për të cilat është paraqitur ankesë, me kërkesën e Komisionit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë kompetent për zgjidhjen e ankesave në shkallën e dytë; dhe

- kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër.

(4) Komisioni për punën e tij miraton rregullore;

(5) Punët teknike-administrative të Komisionit i kryen Ministria e Ekonomisë në pajtim me aktin për organizimin e punës.

(6) Komisioni një herë në vit paraqet raport për punën e vet në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Neni 5

Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozimin e Komisionit miraton:

1) Listën e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

2) Listën e shteteve, organizatave, entiteteve ose individëve ndaj të cilëve ka kufizime në eksportin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

3) Listën e shteteve për të cilat nuk kërkohet “Certifikatë për konsumuesin e fundit”.

III KRYERJA E EKSPORTIT

Neni 6

(1) Eksportuesi mund të eksportojë mallra dhe teknologji me përdorim të dyfishtë në bazë të lejes për eksportin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë (në tekstin e mëtejme: Leja për eksport).

(2) Lejen për eksport nga paragrafi (1) të këtij neni e lëshon Ministria e Ekonomisë (në tekstin e mëtejme: Ministria).

(3) Leja për eksportit nevojitet edhe për rastet kur mallrat dhe teknologjitë nuk janë përfshirë me Listën nga neni 5 pika (1) të këtij ligji, nëse eksportuesi është i njoftuar nga Ministria e Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë ose organi tjetër kompetent, se ai mall ose ajo teknologji tërësisht ose pjesë të tij/saj, janë ose mund të dedikohen për zhvillimin, prodhimin, administrimin, përdorimin, mirëmbajtjen, magazinimin, zbulimin, njohjen ose përhapjen e armëve kimike, biologjike ose bërthamore ose për zhvillimin, prodhimin, mirëmbajtjen dhe magazinimin e raketave me aftësi për bartjen e armëve të këtitilla.

(4) Leja për eksport nevojitet edhe në rastet kur mallrat dhe teknologjitë nuk janë përfshirë me Listën nga neni 5 pika (1) të këtij ligji, nëse eksporti kryhet në vendin blerës ose vendin e destinimit të fundit për të cilin Këshilli i Sigurimit të OKB-së me rezolutë obligative ka vendosur embargo për eksportin e armëve, ose me vendimi të OSBE-së, ose me embargo për eksportin e armëve në UE të cilës Republika e Maqedonisë i është bashkëngjitur.

(5) Leja për eksport lëshohet edhe për eksportin e mallrave me përdorim të dyfishtë që nuk janë përfshirë me Listën nga neni 5 pika (1) të këtij ligji, nëse eksportuesi është informuar nga organi nga paragrafi (3) të këtij neni se mallrat janë ose mund të jenë të dedikuara tërësisht ose pjesërisht për përdorim si pjesë ose komponentë e mallrave luftarake.

(6) Eksportuesi të cilit i është e njohur, ose ka bazë të dyshojë se malli ose teknologjia me përdorim të dyfishtë do të përdoret për dedikimet nga paragrafët (3) të këtij neni, ndërsa ky mall ose kjo teknologji nuk është në Listën nga neni 5 pika (1) të këtij ligji, obligohet për këtë ta njoftojë Komisionin dhe Ministrinë. Komisioni, në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga dita e pranimit të njoftimit, vendos nëse për këtë mall ose teknologji duhet leja e eksportit. Për vendimin e vet Komisioni menjëherë informon eksportuesin dhe Ministrinë.

Neni 7

(1) Eksportuesi obligohet që në Ministri të paraqesë kërkesë për lëshimin e lejes për eksport në formular, formën dhe përmbajtjen e të cilit e përcakton ministri i Ekonomisë.

(2) Në bazë të kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni, ministri i Ekonomisë lëshon lejen për eksport.

(3) Leja për eksport nga paragrafi (2) të këtij neni lëshohet në formular. Formën dhe përmbajtjen e formularit e përcakton ministri i Ekonomisë.

(4) Formularët nga paragrafi (1) dhe (3) të këtij neni duhet të harmonizohen me formularët e standardizuar ndërkombëtarë.

(5) Me kërkesën nga paragrafi (1) të këtij neni duhet të bashkëngjiten të gjitha dëshmitë e nevojshme për vërtetimin e të dhënave të shënuara në kërkesë si karakteristika teknike, skica, plane, fotografi dhe dokumentacion tjetër për identifikimin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

(6) Në shtojcën e kërkesës eksportuesi doemos duhet të paraqesë “Certifikatë për konsumuesin e fundit”.

Neni 8

(1) Ministria obligohet që para lëshimit të lejes për eksport, të kërkojë mendimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme.

(2) Në rastet kur karakteri i mallit ose teknologjisë me përdorim të dyfishtë këtë e kërkon, mendimi kërkohet edhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mbrojtjes së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

(3) Ministrinë nga paragrafi (1) dhe (2) të këtij neni, duhet ta japin mendimin e tyre në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga dita kur është kërkuar mendimi.

(4) Ministria obligohet që ndaj kërkesës për lejen e eksportit nga neni 7 paragrafi (1) të këtij ligji, të përgjigjet në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 60 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës, përkatësisht në afat prej 90 ditësh nëse në procedurën për dhënien e lejes për eksport nevojiten kontrollime plotësuese.

Neni 9

(1) Ministria pas mendimit të marrë paraprakisht nga neni (8) paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji, lëshon lejen për eksport, më së shumti për periudhë prej 1 viti nga dita e lëshimit të lejes për eksport.

(2) Leja për eksport lëshohet në katër ekzemplarë: dy dorëzohen te kërkuesi, prej të cilëve njërin ekzemplar kërkuesi e dorëzon te organi doganor gjatë procesit të eksportit, e njërin e mban për vete, një ekzemplar dërgohet në Drejtorinë Doganore të Republikës së Maqedonisë dhe një ekzemplar ruhet në arkivin e Ministrisë.

(3) Ministria obligohet që një herë në 6 muaj të paraqesë listën e lejeve të lëshuara për eksport dhe kërkesave të refuzuara për marrjen e lejeve për eksport, te Komisioni.

Neni 10

Ministria, me përjashtim nga neni 6 të këtij ligji, varësisht nga lloji i mallit dhe teknologjisë me përdorim të dyfishtë, lloji dhe kohëzgjatja e veprimtarive të eksportit, eksportuesit mund t'i lëshojë një leje për eksport për llojin e njëjtë të mallit dhe teknologjisë me përdorim të dyfishtë për një ose më shumë shtete.

Neni 11

Ministria do ta refuzojë kërkesën për lëshimin e lejes për eksport, nëse vlerëson se eksporti i mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, mund të shkaktojë pasoja të dëmshme, për shkak të:

- rrezikimit të plotësimin të obligimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë;
- rrezikimit të interesave mbrojtëse dhe sigurisë të Republikës së Maqedonisë;
- rrezikimit ose është në kundërshtim me interesat e politikës së jashtme ose interesat ekonomike të Republikës së Maqedonisë;
- mundësisë së shpërthimit ose vazhdimin të konflikteve të armatosura në shtetin që është shfrytëzuesi i fundit i mallrave ose teknologjive me përdorim të dyfishtë;
- mundësisë për përdorimin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë për represion të brendshëm në shtetin e shfrytëzuesit të fundit të atyre mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë;
- qëllimit të përdorimit të fundit dhe rrezikut nga diversionet;
- njohurive të konfirmuara se veprimi i mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë nuk u përgjigjet të dhënave të shënuara në kërkesën e Ministrisë, ose kur eksportuesi ose prodhuesi me kërkesën e Ministrisë nuk kanë mundësuar kontrollin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë ose të dokumentacionit lidhur me të;
- rasteve të tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 12

(1) Ministri aktvendim, me kërkesën e eksportuesit ose me detyrë zyrtare, mund ta shfuqizojë lejen për eksport kur:

- konfirmon se një ose më tepër kushte në bazë të së cilave është lëshuar leja e eksportit, nuk vlejnë mëtej;
- kur eksportuesi nuk i kryen obligimet e përcaktuara në lejen për eksport.

(2) Ministri me aktvendim e anulon lejen për eksportit kur:

- leja e eksportit është lëshuar në bazë të të dhënave të pasakta ose të paplota, ndërsa paraqitësi i kërkesës e ka ditur ose doemos është dashur ta dinte se të dhënat kanë qenë të pasakta dhe të paplota;
- eksportuesi nuk e ka njoftuar Ministrinë për ndryshimet lidhur me mallrat dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë;
- eksportuesi e ka e ka kaluar lejen për eksport te eksportuesi tjetër.

Neni 13

(1) Kundër aktvendimit nga neni 11 dhe 12 të këtij ligji, eksportuesi ka të drejtë ankese në Komisionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për zgjidhje në shkallë të dytë në afat prej 8 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

(2) Ankesa nga paragrafi 1 të këtij neni nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

IV OBLIGIMET E EKSPORTUESIT

Neni 14

(1) Eksportuesi që kryen eksportin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë obligohet:

- të mbajë evidencë të posaçme për eksportin e kryer të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë;
- ta kryejë veprimtarinë në pajtim me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në lejen për eksport;
- për çdo ndryshim të kushteve për kryerjen e eksportit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, ta njoftojë menjëherë me shkrim Ministrinë;

(2) Eksportuesi nuk guxon ta kalojë lejen e eksportit te eksportuesi tjetër.

Neni 15

(1) Eksportuesi, në pjesën e procedurës doganore, doemos duhet ta paraqesë lejen për eksport dhe “Certifikatën për shfrytëzuesin e fundit”, përveç rasteve nga neni 5 pika (3) të këtij ligji.

(2) Organi doganor nuk do të lejojë eksportin nëse nuk janë plotësuar kushtet nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 16

(1) Në rast se Organi doganor ose organet e tjera kompetente kanë dyshim të arsyeshëm se gjatë lëshimit të lejes për eksport, nuk janë marrë parasysh informatat relevante, të dhënat ose rrethanat kanë ndryshuar në mënyrë materiale pas lëshimit të lejes për eksport, do ta suspendojë përkohësisht eksportin në bazë të njoftimit të marrë paraprakisht nga Ministria.

(2) Në rastet kur Organi doganor ka dyshim të arsyeshëm se të dhënat nga “Certifikata për shfrytëzuesin e fundit” nuk janë të sakta, do ta suspendojë përkohësisht eksportin dhe për këtë do ta njoftojë menjëherë eksportuesin, Komisionin dhe Ministrinë.

(3) Eksportuesi obligohet që në afat prej 10 ditësh pas pranimit të njoftimit se kanë ndodhur rrethanat nga paragrafi (2) të këtij neni, të paraqesë në Ministri dëshmi plotësuese me të cilat disponon, me të cilat do ta konfirmojë saktësinë e të dhënave të shënuara në “Certifikatën për shfrytëzuesin e fundit”.

(4) Ministria në afat prej 30 ditësh nga nga dita e pranimit të dëshmive nga paragrafi (3) të këtij neni merr aktvendim përfundimtar.

Neni 17

(1) Eksportuesi duhet doemos t'i ruajë faturat, fletëdërgesat, fletëpranimet, listat e ngarkimit për të gjitha llojet e transportit dhe çfarëdo dokumentacioni tjetër lidhur me mallrat dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë, së paku 5 vjet nga mbarimi i vitit kalendarik në të cilin është kryer çdo transaksion i veçantë eksportues i mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

(2) Dokumentet nga paragrafi (1) të këtij neni i përmban veçanërisht të dhënat si vijon:

- përshkrimin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë që mundëson identifikimin e tyre dhe Listën e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, si dhe shenjën tarifore sipas Tarifës doganore;

- sasinë e mallit në njësi matëse dhe neto peshë;

- emrin e plotë dhe titullin e eksportuesit si dhe të dhënat nga regjistri përkatës;

- emrin e plotë dhe titullin e importuesit të mallit dhe teknologjisë me përdorim të dyfishtë;

- emrin e plotë dhe titullin e shfrytëzuesit të fundit; dhe

-përdorimin e fundit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

V OBLIGIMET E MINISTRIVE DHE ORGANEVE TË TJERA TË ADMINISTRATËS

Neni 18

(1) Në procedurën për eksportin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, me kërkesën e importuesit, Ministria lëshon “Certifikatën për shfrytëzuesin e fundit”.

(2) Ministri i Ekonomisë në pajtim me ministrin e Financave përcakton formën dhe përmbajtjen e “Certifikatës për shfrytëzuesin e fundit” gjatë importit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

(3) “Certifikata për shfrytëzuesin e fundit” është harmonizuar me formularët e standardizuar ndërkombëtarë dhe vërtetuar nga organi kompetent i vendit importues.

(4) Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë mban evidencën e “Certifikatave për shfrytëzuesin e fundit”, gjatë eksportit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, të vërtetuara nga organi kompetent i vendit importues në pajtim me Ligjin për Drejtorinë Doganore dhe Ligjin doganor.

(5) Ministria mban evidencë për lejet e lëshuara për eksport dhe kërkesat e refuzuara për marrjen e lejes për eksport.

Neni 19

Për kryerjen e punëve nga ky ligj, Ministria bashkëpunon me ministri të tjera në Republikën e Maqedonisë, si dhe me organet e shteteve të tjera.

Neni 20

(1) Kontrollin ndaj çdo eksporti të veçantë të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, si dhe kontrollin e të dhënave për mallrat dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë me lejen e lëshuar për eksport, e kryen Organi doganor në pajtim me dispozitat doganore.

(2) Organi doganor ka të drejtë që, në pajtim me këtë ligj të hyjë në lokalet e punës të personave të kyçur në transaksionet eksportuese.

Neni 21

Të dhënat, informatat, dokumentacioni si dhe materialet e tjera që janë marrë në bazë të këtij ligji, mund të përdoren vetëm për dedikimet e parapara me këtë ligj. Të dhënat e marra lidhur me kërkesën për lëshimin e lejes për eksport, që kanë të bëjnë me vlerën e punëve eksportuese dhe sasinë e mallrave dhe teknologjive lidhur me ato, paraqesin informata të klasifikuara me shkallë të besueshmërisë së përcaktuar me ligj.

VI DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 22

(1) Me dënim me para prej 100.000 deri 300.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje eksportuesi person juridik, i cili:

1) kryen eksportin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë pa lejen e lëshuar për eksport në kundërshtim me nenin 6 paragrafi (1) të këtij ligji.

2) kryen eksportin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë në kundërshtim me nenin 6 paragrafi (3) të këtij ligji.

3) kryen eksportin e mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë në kundërshtim me nenin 6 paragrafi (5) të këtij ligji.

4) nuk i njofton Komisionin Ministrinë se mallrat dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë, mund të përdoren në kundërshtim me nenin 6 paragrafi (6) të këtij ligji;

5) e kalon lejen për eksport te eksportuesi tjetër dhe nuk i respekton obligimet e përfshira me nenin 14 paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji;

6) nuk i ruan faturat, fletëdërgesat, fletëpranimet, listat e ngarkimit për të gjitha llojet e transportit dhe çdo dokumentacion tjetër lidhur me mallrat dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë, së paku 5 vjet nga mbarimi i vitit kalendarik në të cilin është kryer çdo transaksion i veçantë eksportues i mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë në kundërshtim me nenin 17 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni do të dënohet edhe personi përgjegjës te personi juridik me dënim me para në shumë prej 10.000 deri 50.000 denarë.

(3) Për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni do të dënohet edhe eksportuesi person fizik me dënim me para në shumë prej 10.000 deri 50.000 denarë.

(4) Për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni personit fizik ose juridik do t'i shqiptohet edhe masa e sigurisë sekuestrim i sendeve - mallrave.

(5) Për veprimet nga paragrafi (10) të këtij neni, përveç dënimit me para personit përgjegjës te personi juridik do t'i shqiptohet edhe masa e sigurisë, ndalim i kryerjes së obligimit me përgjegjësi në kohëzgjatje prej 6 muajsh deri në 1 vit.

(6) Për veprimet nga paragrafi (1) të këtij neni, përveç dënimit me para të personit juridik do t'i shqiptohet masa e sigurisë ndalim i kryerjes së veprimtarisë në kohëzgjatje prej dy deri në katër vjet, kurse personit fizik do t'i shqiptohet masa e sigurisë ndalim i kryerjes së veprimtarisë në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh deri më një vit.

VII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Eksportuesi obligohet që ta harmonizojë kryerjen e eksportit të mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë në afat prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e listave nga neni 5 të këtij ligji.

Neni 24

Qeveria i miraton listat nga neni 5 të këtij ligji, në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.